

100 ditët e para të laktacionit




Në ciklin e laktacionit 100 ditët e para janë faza më domethënëse. Këto 100 ditë përfshijnë periudhën më të lartë të laktacionit, faza e sasisë ditore më të lartë të qumështit për lopët. Gjithashtu në këtë periudhë efikasiteti i ushqimit është më i lartë. Për një prodhim qumështi ekonomik, është domethënëse mbajtja e lopëve sa më gjatë në fazën e laktacionit.

Periudha ndërmjet dy pjelljeve të jetë sa më e shkurtër

Një lopë gjatë periudhës më të dobishme të jetës së saj, duhet të arrijë sa më shumë pika të larta të laktacionit. Në këtë mënyrë është i mundur një rendiment i lartë qumështi për njësi kohe, i cila ndikon pozitivisht në rendimentin jetik dhe në rentabilitetin e prodhimit të qumështit. Më shumë pika të larta laktacioni do të thotë më shumë lindje të viçave për njësi kohe, e cila nga pikëpamja ekonomike nuk duhet neglizhuar. Në këtë kontekst bëhet e qartë rëndësia e pjellorisë së tufës. Vetëm gjatë një periudhe kohore optimale ndërmjet dy pjelljeve, mund të arrihen objektivat e mësipërm. Periudha kohore ndërmjet dy pjelljeve duhet të jetë e orientuar në prodhimtarinë e qumështit, por për tufat me rendiment të lartë periudha ndërmjet dy pjelljeve mbi 400 ditë nuk është fitimprurëse. Në aspektin e menaxhimit të pjellorisë kjo do të thotë që për rreth 100 ditët e laktacionit lopa duhet të jetë mbarsur. Duke marrë parasysh kohëzgjatjen e fazës së regresionit, në fund të periudhës së pritjes nuk mund ketë inseminim, mbeten pothuajse 60 ditë për të arritur mbarështimin. Nga një vështrim i shifrave mesatare aktuale të pjellorisë në Austri, por edhe nga vendet e tjera, u zbulua se objektivat nuk arrihen. Të dhënat e diagnozave tregojnë se normat e prekjes së kafshës nga sëmundjet në 100 ditët e para të laktacionit janë më të larta se në ditët në vijim, e cila ka një

efekt negativ në pjellori. Periudha më e ndjeshme në aspektin e zhvillimit të kafshëve është në periudhën më të lartë të laktacionit. Pjelloria, shëndeti i kafshëve, por edhe ecuria e prodhimit të qumështit janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën. Lopët që janë të shëndetshme gjatë fazës së laktacionit, kanë prodhimtari më të lartë qumështi dhe pjellori të mirë.



FAZA E TRANZITIT

Kritike në aspektin e shëndetit të kafshëve është veçanërisht periudha disa javë para dhe pas pjelljes. Në këtë fazë të ashtuquajtur tranzit, normat e prekjës së kafshës nga sëmundjet janë të larta. Gjatë kësaj periudhe lopët shfaqin vështirësi të mëdha. Jo vetëm pjellja, por edhe nevoja në rritje për energji shfaqet si në fizikun po ashtu edhe në metabolizmin e lopës. Prodhimtaria e qumështit si dhe konsumimi i ushqimit në javët e para të laktacionit është në rritje të shpejtë. Në javët e para të laktacionit bilanci energjistik negativ nuk mund të ndalohet. Një lopë e shëndetshme mund t'a kompensojë këtë defiçit energjie me rezervat trupore, nëse bilanci energjik negativ do të ulet, e cila do të zgjasë më shumë. Nëse lopa për arsye të ndryshme nuk arrin të kompensojë bilancin energjik, atëherë shfaqet problemet në metabolizëm. Sindroma e përqëndrimit të dhjavit, si dhe ketoza janë pasojat e mundshme. Çrregullimet klinike janë vetëm maja e "Ajzbergut". Çrregullimet e metabolizmit në një tufë, mund të jenë të fshehura dhe nuk shfaqin shenja klinike. Si çrregullimet klinike po ashtu edhe ato subklinike të metabolizmit, kanë ndikim të gjerë në shëndetin e lopës së prekur. Ndikimet negative të përkjes së vezës, zhvillimit embrional çojnë në shfaqjen e mastitit, çrregullimeve të

pjellorisë dhe ciklit menstrual. Rritja e suksesshme e prodhimit në punën e mbarështimit në vitet e fundit bën përzgjedhjen e lopëve moderne, por mbi të gjitha në lidhje me ushqimin dhe mirëmbajtjen. Në qoftë se menaxhimi i fermave nga fermerët mbahet në ritmet e duhura, atëherë laktacioni i lartë nuk do të jetë një fazë problematike me shkallë sëmundshmërisë së lartë.

ME STRATEGJI NË LAKTACIONIN E RI

Një metodë strategjike ndihmon periudhën nga pjellja deri në formën optimale të mundshme të mbarështimit tjetër. Strategjia për 100 ditët e para të laktacionit bazohet mbi tre shtylla: Baza është kushti më i mundshëm i kondicionit. Tashmë në pjesën e tretë të paralaktacionit fillon përgatitja për vazhdimin e laktacionit, këtu duhet të bëhet përgatitja e lopës për mbarsje. Në periudhën e tharjes kafshët me kondicion të ulët mund të kenë rritje të lehtë në peshë, përndryshe rrezikohen nga çrregullime metabolike për shkak të mungesës së energjisë. Normalisht në periudhën e tharjes gjendja trupore nuk ndryshon dhe lopa nuk ka gjendjen e duhur trupore në pjellje. Për t'u realizuar kjo është vetëm mbi një stallë të veçantë në periudhën e tharjes dhe një fazë të dytë të ushqimit të thatë. Në vetvete pjellja mundësisht duhet të zhvillohet pa stres, në përputhje me standartet higjienike dhe nevojat e arsyeshme. Gjatë pjelljes është shumë i lidhur regjimi ushqimor, mungesa tipike, si çrregullimi metabolik mbi bazën e një bilanci energjik tepër të theksuar, por gjithashtu mbi bazën e një pjese të niseshtesë dhe të sheqerit në racion. Një mungesë e fibrës në strukturat efektive duhet të shmanget, por jo vetëm formimi i racioneve është zgjidhje. Gjithashtu qëndrimi i faktorëve (numri i lopëve për metër katror, uji, klima/stresi i vapës) në situatat e kërkesës së furnizimit kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme. Shtylla e dytë e suksesshme e menaxhimit të shëndetit është identifikimi i kafshëve të rrezikshme (kafshët që rrezikojnë kafshët e tjera). Në qoftë se identifikojmë kafshët që rrezikohen nga sëmundjet dhe marrim masa për parandalimin në kohë për kafshët e zbuluara në fazat e para të prekjes dhe fillojmë një terapi, mundohemi që sëmundjet klinike t'i parandalojmë në kohë dhe rezultatet e shërimit do të arrijnë maksimumin. Kontrolli i sëmundjeve, do të tregojë qartë shmangien e humbjeve ekonomike dhe të kafshëve. Shtylla e tretë paraqet një program me një objektivi të qartë, që lopën në 100 ditët e fundit të pjelljes t'a mbarsim përsëri. Mbarështimi në pikat kulminante janë të pakta. Kafshët jo mbartëse dhe kafshë me probleme në pjellje do të identifikohen që në fillim dhe diagnoza përcaktohet bashkë me veterinerin.

100 ditët e para të laktacionit janë fat dhe rrezik njëkohësisht. Fat, sepse në këtë periudhë bazë të suksesshme qumështi është një produkt ekonomik. Nga referimi i kafshëve të shëndetëshme, laktacioni i lartë është gjithashtu një fazë përqëndrimi dhe prodhimi i qumështit do të jetë i ndikuar nga një sërë faktorësh. Shumica e këtyre faktorëve mund t'a bëjnë fermerin

aktiv. Një strategji në menaxhimin e pjellorisë dhe shëndetit; në këtë fazë, planet e suksesshme janë një hap i rëndësishëm për një produkt qumështi dhe një ekonomi të suksesshme.

Periudha ndërmjet dy pjelljeve – Realiteti dhe objektivat e synuar

